



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 184 Akti

Nr. 243 Vendimi  
Tiranë, më 4.3.2020

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Roland Ilia</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Relatore</b>
<b>Xhensila Pine</b>	<b>Anëtare</b>

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në datën 2.3.2020, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, me adresë: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** Z. Andi Civici, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe pasi shqyrtoi çështjen mbështetur në nenin 4, të ligjit nr. 84/2016,

### V Ë R E N :

1. Z. Andi Civici është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*.

2. Z. Andi Civici, u shortua në datën 17.9.2018. Relatore e çështjes me short u zgjodh komisionere Valbona Sanxhaktari dhe anëtarë komisionerët Xhensila Pine dhe Roland Ilia. Trupi gjykues ka zgjedhur kryesues për këtë çështje komisionier Roland Ilia. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Theo Jacobs.

3. Në datën 23.9.2018 trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016 dhe në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues.

4. Në datën 2.11.2018 subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues dhe me të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Ai deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Bazuar në nenet 33, 39 e 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

6. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5, e ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

7. Komisionere Xhensila Pine ka paraqitur një kërkesë për dorëheqje nga trupi gjykues i zgjedhur me short për kryerjen e procesit të rivlerësimit të subjektit Andi Civici. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.12.2019, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 84/2016, ka zgjedhur me short trupin gjykues që do të marrë në shqyrtim kërkesën për dorëheqje të komisionere Xhensila Pine nga procesi i rivlerësimit për subjektin Andi Civici.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi ka shqyrtuar kërkesën e komisioneres, ka vendosur në datën 12.12.2019 mospranimin e kërkesës.

8. Në datë 4.2.2020, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e mbledhura për kriterin e pasurisë dhe në vijim vendosi mbylljen e hetimit kryesisht, për subjektin e rivlerësimit, z. Andi Civici, vetëm për kriterin e pasurisë, e në bazë të nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i kaloi barrën e provës për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

9. Komisioni njoftoi në datën 6.2.2020 nëpërmjet postës ekelektronike, subjektin e rivlerësimit z. Andi Civici, për përfundimin e hetimit kryesisht dhe kalimin e barrës së provës, si dhe iu bëne me dije të drejtat në bazë të ligjit për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, lidhur me rezultatet e hetimit të paraqitura nga Komisioni.

10. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe në datën 24.2.2020 ka paraqitur në protokollin e institucionit prova shkresore lidhur me rezultatet e hetimit. Në datën 26.2.2020 dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij për gjetjet e hetimit administrativ të Komisionit. Në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit kërkonte pyetjen me cilësinë e dëshmitarit të një shtetasi dhe riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, aftësitë profesionale dhe kontrollin e figurës.

11. Komisioni, pasi ka marrë provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, ka vendosur të administrojë të gjitha provat shkresore të paraqitura dhe ka refuzuar kërkesën e tij për thirrjen e një dëshmitari, duke i njoftuar vendimin e arsyetuar subjektit të rivlerësimit.

Lidhur me kërkesën për riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, Komisioni ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se nuk pranon kërkesën e tij për riçeljen e hetimit dhe përfshirjen edhe të dy kriterëve të tjera, deri në këtë fazë të hetimit, pasi ka konstatuar problematika lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin i ka kaluar barrën e provës për të dhënë shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Nëse subjekti me shpjegimet dhe me provat e paraqitura do të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, trupi gjykues, pasi t’i vlerësojë ato, do të vendosë lidhur me ecurinë e procesit të rivlerësimit.

Në vijim, Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit, z. Andi Civici, në seancë dëgjimore në datën 2.3.2020.

12. Në datën 27.2.2020 subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një kërkesë për informacion lidhur me veprime procedurale gjatë procesit të rivlerësimit. Në përgjigje të kësaj kërkesë, në datën 28.2.2020, Komisioni i ka kthyer përgjigje subjektit, duke i vënë në dispozicion një kopje të praktikës me kërkesën për dorëheqje të komisioneres Xhensila Pine dhe vendimin e datës 12.12.2020 të trupit gjykues që ka shqyrtuar kërkesën.

13. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në datën 2.3.2020, ora 11:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

14. Subjekti i rivlerësimit ishte prezent në seancën dëgjimore, ku u përfaqësua sëbashku me përfaqësuesen ligjore znj. Irena Reso dhe shpjeguan lidhur me rezultatet e hetimit dhe barrën e provës.

Në përfundim të seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit kërkoi që të riçelet hetimi administrativ, të vlerësohen dy kriteret e tjera, si dhe të rivlerësohet kriteri i pasurisë mbi bazën e provave dhe rezultateve që kanë sjellë provat e paraqitura prej tij për këtë kriter.

15. Trupi gjykues, pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike të datës 2.3.2020, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, vlerësoi shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në vijim të rezultateve të hetimit, arrin në përfundimin se provat e administruara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, për kriterin e pasurisë, kanë nivelin e provueshmërisë dhe subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës për disa prej tyre.

16. Trupi gjykues, referuar parashikimeve të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të Vendimit nr. 3, datë 17.7.2018, të Kolegjit të Apelit, pika 16, e seksionit III, vlerëson se kur provat kanë nivelin e provueshmërisë, vendimi mund të merret bazuar vetëm në atë kriter vlerësimi.

17. Vendimi mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Andi Civici, vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar për kriterin e figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

## PROCESI I RIVLERËSIMIT

18. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të pasurisë të subjektit Andi Civici, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit, ka konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

19. Pavarësisht se sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është autoritet përgjegjës për kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit<sup>1</sup>, Komisioni duhet të kryejë një hetim të thelluar dhe të pavarur.

<sup>1</sup>41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi.”

## RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

20. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016. Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë, si më poshtë.

21. **Apartament me sip. 147,80 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*”, p. \*\*\*, h/\*\*\*, Tiranë**, në vlerën 155.000 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) euro, fituar me kontratën e shitjes me rezervë nr. \*\*\*, datë 22.12.2011, dhe me kontratën përfundimtare të shitjes nr. \*\*\*, datë 1.10.2012.

22. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës “Vetting” transfertat bankare për shlyerjen e vlerës së apartamentit 155.000 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) euro, të cilat janë konfirmuar edhe nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni.

23. Si burim krijimi për apartamentin të blerë në vlerën 155.000 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) euro ka shërbyer: (a) vlera 113.000 (njëqind e trembëdhjetë mijë) euro e përfituar nga shitja e apartamentit në qytetin e Vlorës; (b) hua në vlerën 42.000 (dyzet e dy mijë) euro nga vjehri i subjektit, z. D.H.

24. Lidhur me vlerën 113.000 (njëqind e trembëdhjetë mijë) euro, të përfituar nga shitja e apartamentit në qytetin e Vlorës në vitin 2011, në vlerën 16.800.000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë, Komisioni ka hetuar fillimisht mbi mënyrën e krijimit të pasurisë apartament në qytetin e Vlorës dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura për blerjen e saj nga e cila ka rezultuar sa vijon.

25. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 – blerë apartamentin në Vlorë, në vlerën 6.000.000 (gjashtë milionë) lekë, pa paraqitur ndonjë dokumentacion ligjor referues.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 e ka deklaruar këtë apartament si adresë banimi.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 deklaroi, shtëpi banimi e deklaruar më parë, regjistruar në ZVRPP-në Vlorë si pasuri me nr. \*\*\*, sipas certifikatës së datës 18.11.2008. Subjekti paraqet dokumentacion ligjor shoqëruar – kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 27.10.2008 me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k..

26. Subjekti, i pyetur nga Komisioni, shpjegon:

*“ ... nuk disponoj dokument të vitit 2003 për blerjen e apartamentit, por në mungesë të këtij dokumenti është fakt i provuar nga deklaratat fillestare e pasurisë se kemi marrë hua nga të afërm për blerjen e tij. Ne nuk kishim arsye për të marrë hua në vitin 2003, ndërkohë që apartamentin do ta blinim në 2008... në këtë apartament kanë filluar të banojnë në pranverën e vitit 2005.*

...

*pagesat janë bërë në cash te firma si bëheshin asaj kohe dhe nuk ka ndonjë dokumentacion të ruajtur, pasi kontrata e shitjes është lidhur më 27.10.2008, ka finalizuar gjithçka dhe është bërë regjistrimi i pasurisë.”.*

27. Shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., ku subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë blerë apartamentin, informon sa vijon:

- Në vitin 2003 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë prenotuar një apartament në ndërtesën 8-katëshe, lagjja “\*\*\*”, Vlorë, të ndërtuar në periudhën korrik 2003 – mars 2005. Vlera e apartamentit të prenotuar ka qenë 6.000.000 (gjashtë milionë) lekë dhe pagesa është

kryer në arkën e shoqërisë gjatë periudhës së ndërtimit. Në arkivën e shoqërisë nuk ekzistojnë dokumente të arkës së atyre viteve.

- Akti i shitblerjes për kalimin e pronësisë është bërë me kontratën nr. \*\*\*, datë 27.10.2008.

28. Burim i të ardhurave për blerjen e apartamentit në qytetin e Vlorës në vitin 2003 janë huat në vlerën 7.000.000 (shtatë milionë) lekë, marrë tek të afërmit e familjes, përkatësisht: (i) hua marrë vjehrrit, z. D.H., në vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë; (ii) hua marrë dajës së bashkëshortes, z. Th.M., në vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë; (iii) hua marrë babait të subjektit, z. Ll.C., në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë.

Subjekti ka sqaruar se vlera e apartamentit ka qenë 6.000.000 (gjashtë milionë) lekë dhe diferencën prej 1.000.000 (një milion) lekë, të shumës së marrë hua, është përdorur për mobilimin e apartamentit.

29. Subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore huan e marrë, si dhe në vazhdimësi shlyerjen e saj. Ai deklaroi se nuk ka kontrata për këto hua të marra.

Nga hetimi nuk ka rezultuar ndonjë dokumentacion provues i kohës, përveç deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore, që të provojë marrjen e këtyre huave, apo në vijim kthimin e tyre.

### **30. Komisioni hetoi mbi mundësitë financiare dhe burimin e të ardhurave të z. D. H., për dhënie e huas në vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë në vitin 2003.**

30.1 Për të provuar këtë fakt janë administruar:

- a) Kopje e vendimit nr. \*\*\* regj., datë 20.7.1998, të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Vlorë, ku z. D.H., regjistrohet si person fizik me qëllim ushtrimin e veprimtarisë private në fushën e avokatisë.
- b) Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Vlorë, ku z. D.H., rezulton të jetë i siguruar si person fizik me nr. \*\*\*, për periudhën 16.2.1999 – 31.12.2004, si dhe dokumentacion lidhur me pensionin e përfutur më tej nga z.D.A.
- c) Informacion nga Bashkia Vlorë se subjekti tregtar “\*\*\*\*” me NIPT \*\*\* ka qenë i regjistruar pranë këtij institucioni dhe ka aplikuar për mbyllje në datën 20.4.2015. Për periudhën 1999 – 2006 nuk disponojnë të dhënë në regjistrin e tatimpaguesve në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, për këtë subjekt.
- ç) Vërtetim i paraqitur nga subjekti, marrë nga Bashkia Vlorë, datë 17.10.2016, sipas të cilit personi fizik “\*\*\*\*” ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifave vendore për periudhën 1998 – 20.4.2015.
- d) Informacion nga Qendra Kombëtare e Biznesit se shtetasi D.H., figuron të jetë regjistruar si person fizik me NIPT \*\*\* në datën 27.3.2003. Aktualisht subjekti është me status “çregjistruar”.
- dh) Informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë ku shtetasi D.H., figuron i regjistruar si person fizik në datën 27.3.2003 me NIPT \*\*\* dhe veprimtari “aktivitete juridike”. Në datën 27.5.2015 ky subjekt është çregjistruar nga regjistrat e administratës tatimore.

30.2 Nisur nga mospërputhjet e konstatuara, Komisioni i ka rikërkuar informacion Bashkisë Vlorë për të saktësuar të ardhurat nga avokatia të z. D.H., në periudhën 1998 – 2006.

30.3 Në vijim, Bashkia Vlorë konfirmon se për këtë periudhë nuk ka regjistra të asnjë tatimpaguesi pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore pranë kësaj bashkie dhe, për rrjedhojë, nuk mund të vëre në dispozicion dokumentacion në lidhje me detyrimet tatimore të paguara nga z. D.H.

31. Subjekti, i pyetur nga Komisioni, ka shpjeguar se *vjehri i tij ka ndërruar jetë në datën 8.6.2017 dhe në këto kushte, çdo arsyetim i bërë prej tij mbi të ardhurat e z. D.H., bazohet vetëm në një orientim të ligjit të kohës dhe provave që ka mundur të sigurojë.*

Subjekti ka deklaruar të ardhurat e z. D.H., janë ato nga pagat dhe pensionet e tij dhe të bashkëshortes, duke filluar nga viti 1962, si dhe të ardhurat nga avokatia të z. D.H., në periudhën 1998 – 2003.

31.1 Në mbështetje të deklaramit të tij, subjekti ka paraqitur:

- a) vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore mbi të ardhurat nga pagat e bashkëshortëve për periudhën 1994 – 2003, si dhe kopje të vërtetimit nga Bashkia Vlorë;
- b) kopje të 117 vendimeve gjyqësore për periudhën 1999 – 2002, për të provuar se z. D.H., ka ushtruar efektivisht punën e avokatit dhe se ka fituar të ardhura të konsiderueshme;
- c) vërtetim nga “Raiffeisen Bank”, sipas të cilit znj. M.H., në periudhën 1997 – 2004, ka pasur në këtë bankë depozita që variojnë nga 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekë (viti 1997) deri në 6.084.271 (gjashtë milionë e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e një) lekë (viti 2004).

Subjekti e ka paraqitur vërtetimin nga “Raiffeisen Bank” duke arsyetuar se: *“të paktën prej vitit 1997 dhe në vazhdim, për aq sa është i mundur verifikimi në një kohë kaq të hershme, i ndjeri D.H., ka pasur të ardhura të konsiderueshme të cilat i mundësonin dhënien e huas.”.*

31.2 Subjekti i ka kërkuar Komisionit që i ndodhur në kushtet e pamundësisë për të provuar të ardhurat e përfituara nga vjehri i tij në këto vite, të mbahet në konsideratë vlera/fasha minimale e të ardhurave nga biznesi, duke llogaritur fitimin e mundshëm mbi to.

32. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në përgjigjet e dërguara nga subjekti, Komisioni konstatoi se:

- a) Provohet regjistrimi në gjykatë i z. D.H., si avokat në vitin 1998 dhe pagesa e sigurimeve shoqërore për periudhën 1999 – 2004 si person fizik.
- b) Pranohet fakti se z. D.H., ka ushtruar aktivitetin e avokatit që nga viti 1999, provuar nga dokumenti i regjistrimit të tij në gjykatë, deklarimi i pagesës së sigurimit vullnetar për pensionin e pleqërisë dhe vendimet gjyqësore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, por nuk provohet pagimi i tatim-taksave gjatë ushtrimit të aktivitetit.
- c) Konfirmohet nga llogaritë bankare se bashkëshortët H., kanë pasur likuiditete në bankë deri në datën 31.12.2003, në vlerën 6.529.297 (gjashtë milionë e pesëqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.
- ç) Nga administrata tatimore apo pushteti vendor/bashkia, nuk provohet regjistrimi i subjektit në organet tatimore apo të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar për periudhën 1998 – 2003. Pavarësisht pretendimeve të subjektit lidhur me mungesën e dokumentacionit dhe kërkesën e tij për llogaritjen e të ardhurave në fashën minimale, mbetet i paprovuar regjistrimi i subjektit në organet tatimore qendrore apo vendore.

**33. Në bazë të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. D.H., në kuptim të nenit D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës, lidhur me mundësinë e tij për të dhënë hua në vitin 2003 vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë, nga të ardhura të ligjshme.**

34. Në shpjegimet vijuese të rezultateve të hetimit, subjekti ka paraqitur edhe pesë vendime gjyqësore të vitit 1998, me të cilat dokumentohet fakti se ka ushtruar profesionin që nga shtatori i vitit 1998. Në total, subjekti ka depozituar 122 vendime për periudhën korrik 1998 – dhjetor 2002.

Subjekti ka deklaruar se: *“Paraqita vendime gjyqësore vetëm këtë periudhë, pasi huaja është dhënë në vitin 2003. Të gjitha vendimet gjyqësore të paraqitura janë me palë kundërshtarë ose gjykime penale. Një gjykim civil i një rëndësie të thjeshtë, kushton jo më pak se 100.000 (njëqind mijë) lekë, pasi vetëm përpilimi i një padie kushton 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe këtu po flas për zgjidhje martese si një nga gjykimet më të thjeshta e me formale. Ndërkohë që të gjithë ju e keni të qartë se një gjykim pronësie, me padi e kundërpadi ka pasur vlerë të konsiderueshme në tregun e avokatisë.”*

35. Subjekti, në shpjegimet e tij, kërkon të mbahet në konsideratë fakti që nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 14.11.2019, e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vlorë, ka rezultuar se për periudhën 1998 – 2006, aktualisht në këtë bashki nuk ka regjistra të asnjë tatimpaguesi dhe, për rrjedhojë, nuk mund të vërë në dispozicion dokumentacionin në lidhje me detyrimet tatimore të paguara nga të tjerët dhe nga z. D.H.

Subjekti deklaron se ndodhet në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e burimit të krijimit, konform nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që ka një sërë provash të tjera të paraqitura si vërtetime bankare dhe vendime gjyqësore, të cilat provojnë se i ndjeri ka ushtruar funksionin e avokatit dhe për periudhën 1998 – 2003 ka pasur një volum pune shumë të lartë si avokat.

36. Në lidhje me të ardhurat e tjera të bashkëshortëve H., subjekti ka kërkuar të përfshihen edhe të ardhurat nga pagat dhe pensionet e tyre nga viti 1994 e në vazhdim, duke përfshirë edhe nënën e z. D.H., e cila ka jetuar gjatë gjithë jetës me të birin.

Subjekti ka pretenduar në shpjegimet e tij *se bashkëshortët H., deri në vitin 2004 rezultojnë të kenë pasur gjithsej vetëm në llogari bankare shumën 11.850.524 (njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e katër) lekë. Nga kjo shumë ata kanë tërhequr jashtë sistemit bankar para vitit 2003, vit i dhënies së huas, shumën 5.766.253 (pesë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekë. Ndërkohë, ata kanë pasur në bankë deri në datën 31.10.2004, depozitën e kursimit me nr. \*\*\*, në shumën 6.084.271 (gjashtë milionë e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e një) lekë.*

Subjekti pretendon se i ndjeri i ka pasur gjendje *cash* (të tërhequra nga banka në vitin 2002) minimalisht shumën e depozitave, në total 5.766.253 (pesë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekë, pra ka pasur mundësi t’i japë hua në vitin 2003 dhe se ka vazhduar të ketë në bankë vlerën 6.084.271 (gjashtë milionë e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e një) deri në vitin 2004.

37. Lidhur me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbi barrën e provës për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të të ndjerit D.H., për dhënien e huas në vitin 2003 në vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë, trupi gjykues vlerëson se mbetet e paprovuar, me dokumentacion ligjor, që subjekti të jetë regjistruar në organet tatimore të pushtetit qendror apo atij vendor. Referuar legjislacionit të kohës, subjektet që regjistroheshin si person fizik në gjykatë duhej në vijim të aplikonin dhe të regjistroheshin edhe në organet tatimore përkatëse, duke deklaruar aktivitetin që ushtronin. Të gjithë personat që kanë ushtruar profesionin e avokatit (si të vetëpunësuar të vetëm apo si punëdhënës) kanë qenë të detyruar bazuar në ligjin nr.7681, datë 9.3.1993, “Për administrimin e tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë”, të regjistrohen dhe të deklarojnë të ardhurat e tyre të realizuara nga ushtrimi i aktivitetit privat. Kriteri kryesor në vendosjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore, për personin fizik që ka ushtruar profesionin e avokatit ka qenë qarkullimi/të ardhurat e vetëdeklaruarat dhe të realizuara në vitin fiskal, i cili përkon me vitin kalendarik. Legjislacioni tatimor nuk ka pasur diferencime për asnjë kategori personash që të ushtrojnë veprimtari ekonomike pa u regjistruar më parë në administratën tatimore, në këtë kuptim dhe profesioni i avokatit ka pasur të gjitha detyrimet për regjistrim si gjithë personat e tjerë.

Referuar legjislacionit të kohës rezulton se tatimpaguesit e kategorizuar si “biznes i vogël” nga viti 1992 – 2006 janë administruar nga drejtoritë rajonale tatimore për llogaritjen dhe ndjekjen e pagesës së detyrimeve tatimore. Të gjitha detyrimet tatimore për këtë periudhë duhet të paguheshin në zyrat postare, në llogari të ish-degëve të tatimeve apo drejtorive rajonale përkatëse në rrethe. Nga informacionet e mbledhura ka rezultuar se këto fatura nuk rezultojnë të regjistruara në sistemet e tatimeve në ditët e sotme, pasi ato mbledheshin manualisht.

38. Trupi gjykues vlerëson se subjekti mund të ndodhet në kushtet e pamundësisë për të provuar në këtë kohë pagimin e tatimit përkatës nga aktiviteti privat i z. D.H., pasi vetë sistemi nuk i ka ruajtur ato, si dhe për faktin se z. D.H., ka ndërruar jetë. Por, Komisioni vlerëson se nuk u paraqit asnjë provë nga e cila të krijohej bindja se z. D.H., të jetë regjistruar në organet tatimore përkatëse deri në vitin 2003, sipas legjislacionit në fuqi, dhe të ketë vetëdeklaruar qarkullimin apo të ardhurat e realizuar. Ushtrimi i aktivitetit të avokatit i provuar nëpërmjet vendimeve gjyqësore nuk provon se të ardhurat e përfituara prej tij janë të ligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Po ashtu, pamundësia e subjektit për të vërtetuar pagimin e taksave nga huadhënësi dhe llogaritja e të ardhurave në fashën minimale, mund të pranohej nëse së paku do të provohej regjistrimi i tij pranë organeve tatimore përkatëse, i cili nga të dhënat figuron i regjistruar si person fizik në datën 27.3.2003 me NIPT \*\*\* dhe veprimtari “aktivitete juridike”.

39. Fakti se bashkëshortët H., kanë pasur likuiditete në bankë në ato vite nuk provon se të ardhurat e gjeneruara në bankë janë nga të ardhura të deklaruar në organet tatimore dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore përkatëse. Po ashtu, nuk provohet në ndonjë mënyrë se ato likuiditete t’i jenë dhënë subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes për blerjen e apartamentit.

40. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se bashkëshortët H., nuk kanë pasur mundësi financiare nga të ardhura të ligjshme, për dhënien e huas në vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë në vitin 2003, subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, pasi edhe sikur të vlerësojë se të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit privat të avokatit kanë shërbyer për të jetuar dhe të ardhurat nga pensionet janë kursyer, ato nuk do të ishin të mjaftueshme për dhënien e huas. Aftësia kursyese e familjes H., deri në vitin 2003, pa përfshirë të ardhurat nga avokatia, ka qenë në vlerën 634.664 (gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë.

41. Mbështetur në deklaratat periodike vjetore, subjekti ka deklaruar se ka shlyer në vijimësi këtë hua. Nga një analizë mekanike e kryer nga Komisioni rezulton e provuar potencialisht mundësia për kthimin e kësaj huaje. Por as në rastin e marrjes së huas dhe as në rastin e kthimit të saj pjesërisht apo në përfundim të likuidimit të saj, bashkëshortët Civici nuk kanë paraqitur ndonjë dokumentacion ligjor provues të kohës, përveç deklarimeve të tyre për të provuar marrjen apo kthimin përkatësisht sipas vlerave të deklaruara prej tyre në deklaratat periodike.

Në një vlerësim të kësaj situatë, referuar marrëdhënies së tyre të posaçme me huadhënësin, kjo nuk përbën një detyrim ligjor, por në vlerësim të trupit gjykues dokumentimi i tyre gjatë kohës së marrjes dhe dhënies do të ndikonte në krijimin e bindjes së brendshme për anëtarët e trupit gjykues, mbi ekzistencën e kësaj marrëdhënieje.

#### **42. Komisioni hetoi mbi mundësitë financiare dhe burimin e të ardhurave të z. Th.M., për dhënien e huas në vitin 2003, në vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë.**

42.1 Për të provuar këtë fakt janë administruar:

- a) Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 24.9.2019, e z. Th.M., sipas së cilës në vitin 2003 i ka dhënë hua vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë mbesës së tij, znj. E.C., dhe bashkëshortit me qëllim blerjen e apartamentit në qytetin e Vlorës, e cila është dorëzuar pa kontratë, pa interes dhe pa ndonjë mandat përkatës. Huaja është shlyer *cash*, pa mandate dhe pa kontratë: në vitin 2004 - 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë; në vitin 2005 - 800.000 (tetëqind mijë) lekë; dhe në vitin 2006 - 300.000 (treqind mijë) lekë.



Të dhënat përpunohen me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore përkatëse.

- b) Fashikullin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2017, i cili ka nisur mbi kallëzimin e datës 13.7.2017, të z. Th.M., ku shpjegon se në vitin 2009 i ka dhënë hua dy shtetasve vlerën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro, të cilën do ta përdornin për të blerë mallra në funksion të aktivitetit të tyre tregtar. Z. Th.M., ka kërkuar fillimin e ndjekjes penale ndaj shtetasve të mësipërm për kryerjen e veprës penale “mashtim”. Nga fashikulli rezulton se këtë vlerë z. Th.M., e ka dhënë pa asnjë dokumentacion.
- c) Gazetën “\*\*\*\*” të datës 4.8.1998, e cila i referohet ngjarjes së datës 3.8.1998, kur z. Th.M., i kanë grabitur maskat e armatosura shumën 60.000.000 (gjashtëdhjetë milionë) lireta në vendin ku ushtronte aktivitetin, për të vërtetuar zhvillimin e aktivitetit të kambizmit, si dhe faktin që shteti e lejonte dhe e konsideronte të ligjshëm këtë aktivitet.
- ç) Informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve se z. Th.S.M., figuron i regjistruar si administrator i subjektit “\*\*\*\*” sh.p.k., veprimtari private në fushën e këmbimit valutor me detyrime tatimore 20.000 (njëzet mijë) lekë.
- d) Pasqyrat financiare për subjektin “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 2008 – 2017, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, por nuk jep informacion mbi të ardhurat e z. Th.M., deri në vitin 2003.

43. Në shpjegimet e tij subjekti ka sqaruar se ai dhe bashkëshortja iu drejtuan të afërmeve të tyre, të cilët kishin mundësi financiare për huadhënie, pasi në vitin 2003 procesi i kredithënies ishte shumë i vështirë dhe atyre iu nevojitej një kolateral (të cilin nuk e kishin) me qëllim përfitim të një kredie.

Subjekti ka shpjeguar se z. Th.M., është daja i bashkëshortes, i cili ka ushtruar profesionin e kambistit që nga viti 1993 e në vazhdim. Aktualisht, vazhdon të ushtrrojë të njëjtin aktivitet me NIPT \*\*\*.

Në lidhje me burimin e të ardhurave të z. Th.M., subjekti deklaron se kanë qenë të ligjshme në konceptin e kohës, për sa kohë punonte ndershmërisht për të siguruar të ardhurat.

Gjithashtu, subjekti sqaron se nuk kishte arsye për të marrë huan me dokumentacion ligjor, pasi ishin në lidhje të afërt gjinore dhe për më tepër natyra e veprimtarisë së këtij shtetasi edhe me persona të tjerë ka qenë e ngritur mbi baza mirëbesimi.

**44. Në bazë të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. Th.M., në kuptim të nenit D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës, lidhur me mundësinë e tij për të dhënë hua në vitin 2003 vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë, nga të ardhura të ligjshme.**

45. Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se lidhur me burimin e shumës së marrë hua nga z. Th.M., ka paraqitur prova të mjaftueshme për të provuar se ky shtetas (daja i bashkëshortes) ka ushtruar profesionin e lirë të kambistit.

Subjekti thekson se në vitin 1993 kur z. Th.M., ka nisur këtë profesion të lirë nuk ka ekzistuar koncepti i burimit të ligjshëm, sikundër parashikohet sot në ligjin specifik të vitit 2016. Kjo është dhe arsyeja që si kambist nuk i ka lindur ndonjë problem me shtetin apo tatimet, apo t’i jenë konsideruar të ardhurat nga puna, si burim i paligjshëm. Aq i vërtetë është ky realitet për ato vite, sa edhe për personat që humbën paratë në firmat piramidale në vitin 1997, shteti nxori ligje dhe VKM për t’ua kthyer. Shteti, kur miratoi këto akte ligjore nuk i pyeti shtetasit e tij nëse kishin paguar tatimet për paratë që kishin futur në këto firma apo edhe për paratë që kishin fituar nga përqindja prej tyre.

46. Lidhur me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për barrën e provës mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. Th.M., për dhënien e huas në vitin 2003 në vlerën

3.000.000 (tre milionë) lekë, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë ligjshmërinë e të ardhurave të huadhënësit, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 32/4, të ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, subjekti nuk ka arritur të provojë as mundësinë financiare të subjektit për dhënien e kësaj huaje në vitin 2003, pasi ushtrimi i veprimtarisë së kambistit nuk do të thotë detyrimisht se ka pasur mundësi financiare për të dhënë huan, pasi nuk ka asnjë të dhënë mbi qarkullimin apo fitimin e tij nga ky aktivitet. Në një logjikë të thjeshtë mund të mendohet se paratë në qarkullim për kryerjen e këtij aktiviteti, të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij, nuk janë domosdoshmërisht të ardhura/fitimi personal i individit, por edhe nëse do të ishin, duhet të shërbenin për kryerjen e aktivitetit informal.

47. Nga një vështrim i përgjithshëm i legjislacionit shqiptar vërehet se veprimtaria e kambizmit është përfshirë në legjislacionin rregullator shqiptar rreth viteve 2007. Edhe pas këtij rregullimi në tregun jozyrtar përfshihen një grup individësh të cilët kryejnë këmbime valutore dhe që janë të palicencuar. Si të tillë, ata nuk i nënshtrohen zbatimit të asnjë rregulli që ka miratuar Banka e Shqipërisë për tregun valutor, si dhe nuk raportojnë. Në gjuhën e përditshme këta individë quhen “kambistë të lirë”. Sipas të dhënave ata veprojnë në mënyrë të dukshme që prej fillimit të viteve '90. Midis këtyre dy tregjeve ose dy grupeve të operatorëve qëndrojnë bizneset dhe individët të cilët këmbëjnë monedhat për nevoja të përditshme, për nevoja investimi apo kursimi. Shkalla e përdorimit të dy përbërësve të tregut valutor është e ndryshme.

48. Lidhur me këtë hua gjatë hetimit nuk rezultoi asnjë dokument i kohës lidhur me marrjen e kësaj huaje apo kthimin e saj përkatësisht në vitet 2004, 2005 dhe 2006, sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore. Pavarësisht faktit se kjo nuk përbën një detyrim ligjor, ekzistenca e tyre do të shërbente në raport me bindjen e brendshme të anëtarëve të trupit gjykues mbi ekzistencën e kësaj marrëdhënieje.

49. Në vlerësim të trupit gjykues subjekti nuk arriti të provojë mundësitë financiare të z. Th.M., për dhënien e kësaj huaje dhe as burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua. Po ashtu, as marrjen apo kthim e kësaj huaja sipas deklarimeve të subjektit.

## **50. Komisioni hetoi mbi mundësitë financiare dhe burimin e të ardhurave të z. Ll.C., për dhënien e huas në vitin 2003, në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë.**

50.1 Për të provuar këtë fakt janë administruar:

- a) Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 25.9.2019, e z. Ll. C., ku deklaroi se në vitin 2003 i ka dhënë hua shumë 1.000.000 (një milion) lekë djalit të tij, z. Andi Civici dhe bashkëshortes, me qëllim blerjen e apartamentit në qytetin e Vlorës. Kjo hua është dorëzuar pa kontratë apo akt me shkrim dhe është shlyer në vitet 2006 [në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë] dhe në vitin 2007 [në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë].  
Deklarimet e subjektit të rivlerësimit përputhen me deklaratat e bëra në deklaratat periodike vjetore përkatëse.
- b) Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti mbi: të ardhurat nga punësimi i babait, z. Ll.C., për periudhën janar 1994 – dhjetor 2003; të ardhurat nga punësimi i nënës, znj. R.C., për periudhën janar 1994 – dhjetor 2003.
- c) Dokumenti bankar se z. Ll.C., ka pasur likuiditete të depozituara në bankë, në vlerën 1.834.607 (një milion e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e shtatë) lekë në fund të vitit 2003.

51. Subjekti shton se prindërit e tij kanë nisur punë që në vitin 1972 dhe se kanë përfituar interesa nga llogaritë e tyre bankare ndër vite. Gjithashtu, babai i subjektit ka qenë profesor matematike dhe ka siguruar të ardhura shtesë nga kurset private të zhvilluara pas vitit 1991, sikundër shumë profesorë të tjerë në praktikën e kohës.

52. Komisioni përlllogaritë aftësinë e kursimit të prindërve të subjektit për periudhën 1994 – 2003, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, nga e cila rezulton se kanë pasur

mundësi të kursejnë nga të ardhurat me burime të ligjshme vlerën 1.258.606 (një milion e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtë) lekë deri në fund të vitit 2003, e cila duket e mjaftueshme për dhënien e huas së vlerës 1.000.000 (një milion) lekë subjektit të rivlerësimit në vitin 2003.

Përshkrimi	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	TOTALI
Të ardhura neto nga punësimi Ll. C.	65 664	93 735	124 181	130 024	160 344	178 748	186 746	206 075	225 293	238 884	<b>1 609 694</b>
Të ardhura neto nga R.C.	0	14 363	115 436	121 439	97 825	123 551	162 772	143 127	348 613	356 136	<b>1 483 262</b>
Të ardhura nga interesa bankare	0	0	0	0	0	0	0	112 725	51 196	77 464	<b>241 385</b>
<b>Total të ardhura 1994 - 2003</b>	<b>65 664</b>	<b>108 099</b>	<b>239 617</b>	<b>251 463</b>	<b>258 169</b>	<b>302 299</b>	<b>349 518</b>	<b>461 926</b>	<b>625 103</b>	<b>672 484</b>	<b>3 334 340</b>
Shpenzime jetike	45 965	75 669	167 732	240 000	240 000	180 000	281 592	281 592	281 592	281 592	<b>2 075 734</b>
Aftësia për të kursyer	<b>19 699</b>	<b>32 430</b>	<b>71 885</b>	<b>11 463</b>	<b>18 169</b>	<b>122 299</b>	<b>67 926</b>	<b>180 334</b>	<b>343 511</b>	<b>390 892</b>	<b>1 258 606</b>

**53. Nga hetimi ka rezultuar gjithashtu se z. Ll.C., ka pasur likuiditete të depozituara në bankë, në vlerën 1.834.607 (një milion e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e shtatë) lekë në fund të vitit 2003.**

**Nisur nga fakti se huaja është dhënë më herët gjatë vitit 2003, subjektit i është kërkuar të shpjegojë lidhur me mundësitë financiare të prindërve për të dhënë hua shumën 1.000.000 (një milion) lekë në vitin 2003, kur njëkohësisht ata dispononin likuiditete në bankë në fund të këtij viti.**

54. Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar se prindërit e tij kanë nisur punë në vitin 1972 dhe në familje ka qenë pjesëtare, përveç prindërve, edhe gjyshja, znj. K.C. Të ardhurat e familjes së prindërve përbëheshin nga pagat e tyre, pensioni i gjyshes dhe të ardhurat nga kurset e matematikës që zhvillonte i ati, si të gjithë profesorët e tjerë në Republikën e Shqipërisë.

Subjekti thekson se nuk është në gjendje të përcaktojë se nga cila pjesë e të ardhurave buroi huaja që i dhanë prindërit në atë periudhë, por në kushtet kur provohet se babai mund t'i jepte këtë shumë nga burime të ligjshme, pasi mund të kursente deri në atë kohë shumën e dhuruar (sikundër rezulton edhe nga analiza financiare e kryer nga Komisioni), në kuptim të nenit D, paragrafi 3, të Kushtetutës, çmon se provon mundësinë e dhënies hua. Subjekti shton se shuma e dhuruar nga prindërit mund të ishte konsideruar dhe dhuratë për martesë, por ai dhe bashkëshortja nuk e pranuan një gjë të tillë dhe preferuan ta marrin hua dhe t'ua shlyejnë prindërve, po me të ardhura të ligjshme nga pagat e tyre.

55. Lidhur me shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion provues të kohës lidhur me marrjen e kësaj huaje apo dhe kthimin e saj, përveç deklarimeve të bëra përkatësisht nga ai në deklaratat periodike vjetore. Referuar marrëdhënies së tyre të posaçme me huadhënësin, kjo nuk përbën një detyrim ligjor, por në vlerësim të trupit gjykues dokumentimi i tyre gjatë kohës së marrjes dhe dhënies do të ndikonte në krijimin e bindjes së brendshme për anëtarët e trupit gjykues mbi ekzistencën e kësaj marrëdhënieje.

Duke vlerësuar se të ardhurat e huadhënësve janë të mjaftueshme për dhënien e huasë, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka përmbushur detyrimin që rrjedh nga neni 32/4, i ligjit nr.84/2016 për të shpjeguar mbi mundësinë e huadhënësve për dhënien e shumës 1.000.000 (një milion) lekë nga të ardhura të ligjshme dhe vlerëson se likuiditetet në bankë të huadhënësve në fund të vitit 2003 mund të kenë qenë nga burime të tjera.

## **Konkluzion në lidhje me huat e marra për shtëpinë e prenotuar në vitin 2003**

56. Subjekti dhe bashkëshortja janë emëruar në detyrë gjyqtarë në datën 1.11.2003. Zanafilla e huave të marra nuk mund të lidhet me ushtrimin e detyrës dhe të ardhurat e huadhënësve gjithashtu datojnë para se huamarrësit të emëroheshin gjyqtarë.

Nga hetimi është konstatuar se gjatë viteve 1997 deri në vitin 2001 në Shqipëri kanë operuar edhe organizata ndërkombëtare prestigjioze, si \*\*\* apo projekti i Komisionit European mbi asistencën e doganave \*\*\* Albania, për të cilët gjithashtu është hasur vështirësi në gjetjen e një dokumentacioni provues ligjor për pagimin e taksave dhe tatimeve. Duke njohur realitetin shqiptar të atyre viteve besojmë se informaliteti ka qenë i dukshëm dhe real për këdo.

Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi, krijohet bindja se huadhënësit kenë patur mundësi financiare për dhënien hua të shumave të deklaruara, por as z. D.H., dhe as z. Th.M., nuk rezultuan të regjistruar në organet tatimore dhe për pasojë nuk mund të provohen të ardhurat e tyre nga aktiviteti tregtar dhe as nuk përmbushin kërkesat e nenit D pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.

Në vlerësim të trupit gjykues mbetet gjithashtu e paprovuar marrja e huas apo kthimi i saj te huadhënësit, çka do të krijonte bindjen se detyrimi është zëvendësuar, pasi subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, të dy me detyrë gjyqtarë të Republikës së Shqipërisë, që prej viti 2003, nuk janë përpjekur të dokumentojnë dhe të provojnë veprimet e tyre lidhur me marrjen e këtyre shumave në vitin 2003, dorëzimin e tyre te firma e ndërtimit që në vitin 2003 dhe në vijimësi as kthimin e tyre te huadhënësit, duke u mjaftuar vetëm me deklarime individuale në deklaratën periodike vjetore përkatëse.

Duke zbatuar parashikimin e nenit 32, pika 5, e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “*Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit*”, Komisioni arsyeton se ato janë vetëm deklarime individuale të subjektit të cilat gjatë hetimit nuk u vërtetuan në ndonjë mënyrë tjetër të tërthortë.

Në vlerësim të të gjithë rrethanave dhe fakteve të renditura më sipër, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë bindshëm ligjshmërinë e burimit për krijim e kësaj pasurie, sipas kërkesave të nenit D pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.

**57. Mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në qytetin e Vlorës në vitin 2011, të cilat kanë shërbyer pjesërisht për blerjen e apartamentit në qytetin e Tiranës në shumën 113.000 (njëqind e trembëdhjetë mijë) euro.**

58. Pasuria apartament banimi në qytetin e Vlorës është rivlerësuar në datën 1.12.2011 në vlerën 16.800.000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë, sipas përkrahimit në kartelën e pasurisë. Subjekti deklaroi pagesën prej 109.500 (njëqind e nëntë mijë e pesëqind) lekë për efekt të rivlerësimit të pasurisë në favor të ZVRPP-së (diferencës ndërmjet shumës së rivlerësimit dhe vlerës fillestare së blerjes së apartamentit).

Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me kërkesë të Komisionit, ka dërguar praktikën e rivlerësimit të apartamentit të kryer nga subjekti, sipas raport-vlerësimit, datë 25.11.2011, të kryer nga vlerësuesi i pasurive të paluajtshme, ing. Y.M. Sipas këtij raporti, vlera e tregut të apartamentit në datën e vlerësimit është 16.800.000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë, duke konsideruar gjendjen e mirë teknike të pasurisë, sipërfaqen, si dhe vendndodhjen e favorshme të saj në një zonë të preferuar për banim dhe aktivitet tregtar.

59. Subjekti i rivlerësimit e shet këtë apartament me kontratën nr. \*\*\*, datë 18.12.2011, në vlerën 16.800.000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë, shtetasit E.K. Në kontratën e shitblerjes shitësi deklaroi se blerësi e ka paguar *cash* të gjithë çmimin e shitjes jashtë zyrës noteriale.

60. Nga praktika e dërguar nga ZVRPP-ja Vlorë gjendet bashkëlidhur një kontratë shitjeje e kësaj pasurie, në datën 28.2.2012, me palë shitëse z. E.K., dhe palë blerëse z. K.M., në vlerën 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë.

61. Referuar këtyre fakteve si: çmimit të shitjes së apartamentit krahasuar me çmimin e blerjes së tij, diferencës së çmimit të blerjes së apartamentit nga z. E.K., dhe më pas shitjes, pas dy muajve te z. K.M., me një çmim më të ulët, Komisioni ka ngritur dyshime lidhur me çmimin e shitjes në kontratën nr. \*\*\*, datë 18.12.2011, në vlerën 16.800.000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë, me z. E.K., ku përfitues ka qenë subjekti i rivlerësimit.

62. Komisioni ka kryer disa hetime, nga të cilat ka rezultuar, sa vijon.

- a) Sipas Entit Kombëtar të Banesave çmimi mesatar i shitblerjes së pasurisë apartament në tregun e lirë në vitin 2011, në qytetin e Vlorës, ka qenë 60.298 lekë/m<sup>2</sup>. Referuar kontratës së shitjes, subjekti e ka shitur apartamentin me vlerën 111.332 lekë/m<sup>2</sup>.
- b) Subjekti ka deklaruar se z. E.K., është djali i hallës së tij, i cili ka jetuar në Itali në periudhën 1999 – 2009 dhe se ka qenë student në universitetin “\*\*\*”, periudhë në të cilën ka kryer edhe punë të ndryshme, deri në diplomimin e tij. Subjekti ka paraqitur kopje të lejes së qëndrimit të datës 13.9.1999, e rinovuar periodikisht deri në vitin 2006 dhe të kartës së identitetit nr. \*\*\*, të lëshuar në datën 14.6.2005 nga organet kompetente italiane në Romë.
- c) Nga verifikimi në sistemin *TIMS* rezulton në periudhën 2005 – 2011, z. E.K., ka udhëtuar shpesh nga Italia në Shqipëri (rreth 24 herë). Z. E.K., ka qenë në Shqipëri në datën e nënshkrimit të kontratës 18.12.2011.

63. Komisioni hetoi lidhur me mundësitë financiare të z. E.K., për pagimin e shumës 16.800.000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë, mënyrën e sjelljes së tyre në Shqipëri dhe dhënien e tyre subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, nga e cila ka rezultuar si vijon:

a) Nga informacioni bankar i administruar, gjendja e likuiditeteve në bankë të z. E.K., në fund të viteve 2010 dhe 2011 paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Gjendje bankare E.K.	Vlera në lekë
Gjendje më 31.12.2010	7 081 400 lekë
Gjendje më 31.12.2011	8 999 009 lekë

b) Të ardhurat të z. E.K., për periudhën 1999 – 2009, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Të ardhura E.K. (1999 – 2009)	Periudha	Vendi	Koment	Shuma në euro	Shuma në lekë
Të ardhura nga bursa e studimit	e papërcaktuar	Itali	E padokumentuar plotësisht, provuar pagesa e shumës 6,452 euro për 2006 – 2007 nga Enti Rajonal Lazio, ndërsa banka “Unicredit” njofton se ruan dokumentacion vetëm për 10 vjet (sipas legjislacionit italian)	16 000 €	
Të ardhura nga puna si kamerierpart-time “***” S.R.L	janar 2001 – mars 2006	Itali	Të ardhura të pataksuara, subjekti ka paraqitur vërtetim mbi të ardhurat bruto të vitit 2001 lëshuar nga shoqëria	29 505 €	
Të ardhura nga demshpërblimi nga “***” S.R.L	23.7.2007	Itali	Të ardhura të dokumentuara, subjekti ka paraqitur padinë e dorëzuar në gjykatë dhe kopje të çekut për arkëtimin e shumës 4.000 euro	4 000 €	
Të ardhura nga puna pranë “***” srl	30.6.1905	Itali	Të ardhura bruto të dokumentuara me vërtetim nga INPS	9 728 €	
Të ardhura nga puna si COLF pranë z. M. Z.	2009	Itali	Të ardhura pjesërisht të dokumentuara, subjekti ka paraqitur kopje të deklarimit të marrëdhënie së punësimit tek *** dhe të deklaratave mujore të pagës të lëshuar nga punëdhënësi, por nuk provohet pagesa e sigurimeve dhe tatimeve mbi pagën.	4 853 €	
Tërheqje nëpërmjet “***” LTD	2007 – 2011	Itali	Të ardhura si menaxher shitjesh <i>online</i> te kompania angleze “***”, të përfituara në llogarinë pranë “***” në formën e bonusit; nuk provohet pagesa e tatimit mbi këto të ardhura.	78 826 €	

Të ardhura nga paga Universiteti ***	2010	Shqipëri	Të ardhura si menaxher IT, vërtetim nga punëdhënësi për pagën 700 euro/muaj; nga ana tjetër, nga llogaria pranë "Alpha Bank" provohet pagesa vetëm për tre muaj prej 405 euro/muaj. Nuk provohet plotësisht arkëtimi i shumës 8.400 euro dhe nuk provohet pagesa e tatimit mbi këto të ardhura.	8 400 €	
Të ardhura në euro deri në vitin 2011				151 312 €	20 926 393 lekë
Të ardhura nga puna te "Tirana Leasing"	2010-2011	Shqipëri	Të ardhura si oficer kredie pranë "Tirana Bank", dokumentohet përfitimi i pagës në shumën totale 1.219.825 lekë.		1 219 825 lekë
TOTAL					22 146 218 lekë

64. Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit nëse kishte dijeni mbi shkaqet e transaksionit të kryer nga z. E.K., te z. K.M., në vijim të të cilave subjekti shpjegon se arsyeja e shitjes së këtij apartamenti nga z. E.K., brenda një periudhe shumë të shkurtër tek z. K.M., kanë qenë shkaqe shëndetësore të papritura dhe të vlerësuar të rënda në atë kohë, pasi i'u nënshtrua një ekzaminimi mjekësor, nga e cila dyshuan se vuante nga një sëmundje e rëndë.

Subjekti bashkëlidh konsultën mjekësore të datës 7.2.2012, të z. E.K., të lëshuar nga Spitali \*\*\*.

65. Nga hetimi nuk ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit apo bashkëshortja të kenë gjykuar çështje gjyqësore me palë ndërgjyqëse shtetasit E.K., apo K.M.

66. Në lidhje me shitjen e apartamentit në qytetin e Vlorës në vitin 2011, bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje ka rezultuar se:

- Nuk provohet në ndonjë mënyrë të dokumentuar transferimi i shumës 16.800.000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë nga z. E.K., te subjekti i rivlerësimit në vitin 2011.
- Nuk provohet si z. E.K., i i ka transferuar të ardhurat e përfituara në shtetin italian, drejt territorin shqiptar, referuar edhe gjendjeve bankare të tij, duke mos provuar kështu se ai ka disponuar këtë shumë për blerjen e apartamentit në vitin 2011.
- Të ardhurat plotësisht të dokumentuara të z. E.K., për periudhën 1999 – 2011 janë në vlerën 1.872.119 (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë, duke mos provuar plotësisht mundësitë e tij financiare për blerjen e apartamentit.

67. Mbështetur në rezultatet e hetimit, krijohen dyshime se çmimi i shitjes së apartamentit, i deklaruar nga subjekti dhe i pasqyruar në kontratën nr. \*\*\*, datë 18.12.2011, në vlerën 16.800.000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë, nuk është çmimi real i blerjes së apartamentit nga subjekti, referuar:

- faktit që ky çmim rezulton të jetë dy herë më i lartë krahasuar me çmimin e referencës së pasqyruar, duke e krahasuar me çmimin referues për qytetin e Vlorës në vitin 2011, sipas udhëzimit të Entit Kombëtar të Banesave;
- faktit që në datën 28.2.2012, dy muaj pas shitjes nga subjekti i rivlerësimit të apartamentit te kushëriri i tij, ky apartament është rishitur në vlerën 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;
- faktit që me të ardhura të dokumentuara të z. E.K., për periudhën 1999 – 2011, nuk provohet mundësia e tij financiare për blerjen e apartamentit.

**68. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën.**

69. Në shpjegimet e tij lidhur me barrën e provës subjekti ka sqaruar, si vijon:

- Në lidhje me arsyet e blerjes së apartamentit nga z. E.K., në atë kohë, subjekti deklaroi ai se në bashkëpunim dhe në mirëbesim me një shtetas italian kishte rënë dakord për të investuar në fushën e turizmit dhe marketingut, *online*, për shkak të profesionit si menaxher interneti.

Subjekti ka paraqitur një deklaratë të z. M.Z., të datës 30.9.2019, të shoqëruar me kopje të kartës së identitetit dhe me librezë të tij shëndetësore, në të cilën ky shtetas deklaron se: “... z. E.K., përveç se ka punuar në banesën time, kam organizuar me të një sërë aktivitete sportive. Në vitin 2011 vendosëm të kryejmë një investim në qytetin e Vlorës për një projekt biznesi në fushën e turizmit dhe së bashku vendosëm që do të ishte një investim i mirë për të ardhmen. Pas 2 muajsh, z. E.K., me njoftoi se për shkak të një sëmundjeje të rëndë duhet ta shiste këtë apartament, pasi kishte nevojë të merrte menjëherë mbrapsht shumën e investuar. Në këto kushte vendosëm me mirëkuptim shitjen e apartamentit për të cilin ai kishte marrë përsipër detyrimin. Në muajin shkurt 2012 ky apartament u shit dhe ne nuk kemi më detyrime ndaj njëri-tjetrit”.

Subjekti deklaron se z. E.K., e ka shitur apartamentin brenda dy muajve, i nxitur nga rrethana shëndetësore personale të papritura dhe të vlerësuara të rënda në atë periudhë. Në këtë periudhë iu nënshtrua një ekzaminimi mjekësor, nga ku u dyshua se vuante nga një sëmundje shumë e rëndë, për të cilat janë paraqitur provat shkresore të vitit 2012 të ekzaminimit të tij, fakt i provuar dhe nga deklarata e shtetasit italian M.Z.

Subjekti shton se edhe nga pikëpamja juridike diferenca midis çmimit të blerjes dhe të shitjes nuk përbën shkak për fiktivitet, pasi rrethanat për uljen e çmimit mund të jenë nga më të ndryshme dhe njerëzore.

b) Në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit, subjekti thekson se në vitin 2011 nuk ka ekzistuar ndonjëherë apartament që të shitej me çmim 436 euro/m<sup>2</sup> në qendër të qytetit të Vlorës, duke i kontestuar çmimet e referencës sipas Entit Kombëtar të Banesave, pasi ato nuk kanë asnjë lidhje me realitetin.

Për të provuar lidhur me faktin se çmimi i shitjes ka qenë real dhe sipas çmimeve të tregut, subjekti ka paraqitur dy kontrata porosie për blerje apartamenti, në periudhën prill – maj 2011, brenda qendrës së qytetit të Vlorës dhe një kontratë shitjeje për njësi shërbimi.

- Kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 26.4.2011, me objekt ndërtim dhe blerje apartamenti në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë. Sipas kësaj kontrate rezulton se çmimi i shitjes së apartamentit është 795 euro/m<sup>2</sup>.

- Kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 26.5.2011, me objekt ndërtim dhe blerje apartamenti në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë. Sipas kësaj kontrate, rezulton se çmimi i shitjes së dy apartamenteve (me sipërfaqe totale 147.05 m<sup>2</sup>) është 700 euro/m<sup>2</sup>.

- Kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 14.8.2014, me objekt shitjen e një dyqani në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë. Sipas kësaj kontrate, rezulton se çmimi i shitjes është 875 euro/m<sup>2</sup>.

Subjekti thekson se e ka shitur pasurinë sipas vlerës reale të tregut dhe po njësoj ka blerë pasuri sipas vlerës reale të tregut në çdo kohë, si në vitin 2003 dhe në vitin 2011.

Subjekti shpjegon se apartamentin në qytetin e Tiranës e ka blerë me vlerë më të lartë se çmimi që referon Enti Kombëtar i Banesave. Në pallatin ku banon subjekti ka edhe banorë që kanë blerë apartamente me çmim më të lirë sesa e ka blerë subjekti. Subjekti ka paraqitur si provë kontratën nr. \*\*\* rep., datë 7.12.2016, me objekt blerje apartamenti nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në rrugën “\*\*\*\*”. Nga kjo kontratë rezulton se në datën 30.9.2010 blerësi ka përfituar një apartament banimi me çmim 733 euro/m<sup>2</sup>.

c) Në lidhje me të ardhurat e z. E.K., subjekti deklaron se ky shtetas nuk është person tjetër i lidhur, në kuptim të nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016, pasi në të kundërt Komisioni duhet t’i kishte ngarkuar edhe barrën e provës për të ardhurat e të gjithë personave me të cilët ka pasur marrëdhënie shitblerjeje, si firmat apo njerëzit në Gjermani ku janë blerë automjetet, shoqërinë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., ku ka blerë apartamentin apo për personat të cilëve u ka shitur automjetet.

Në vijim, subjekti ka paraqitur dokumente mbi të ardhurat e siguruara nga ky shtetas gjatë gjithë kohës së qëndrimit në Itali dhe në Shqipëri nga viti 1999 – 2011. Subjekti konteston konstatimin

e Komisionit se është provuar plotësisht vetëm një pjesë e burimit të të ardhurave të z. E.K., duke vlerësuar se nuk ka detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. E. K., por vetëm të ardhurat e tij, pasi nuk e konsideron si një nga rastet e parashikuara në nenin 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

ç) Në lidhje me transferimin e të ardhurave në territorin shqiptar dhe pagesën *cash* të çmimit të shitjes së apartamentit, subjekti deklaron se është provuar se z. E.K., ka udhëtuar 24 herë nga Italia në Shqipëri në periudhën 2005 – 2011, ndërkohë në vitet 1999 – 2004, për shkak të mungesës së sistemit *TIMS*, nuk rezulton se sa herë mund të ketë ardhur.

Subjekti ka referuar për këtë rast disa vendime të Kolegjit të Posaçëm të Apelit lidhur me transaksionet *cash*, ku ato janë konsideruar të ligjshme, veçanërisht për vitet 2011 dhe 2012, duke pranuar në këtë mënyrë realitetin e kohës ku të gjitha transaksionet kryheshin *cash* dhe nuk ishte e ndaluar nga ligji .

70. Subjekti ka kërkuar thirrjen e z. E.K., në cilësinë e dëshmitarit, për të dhënë shpjegime rreth blerjes së apartamentit. Kjo kërkesë është refuzuar nga trupi gjykues i Komisionit, duke i vlerësuar si të panevojshme dëshmitë e z. E.K., pasi ato ishin deklaruar gjatë hetimit nga subjekti i rivlerësimit.

71. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues nuk u bind lidhur me shkaqet e shitjes së apartamentit prej z. E.K., dy muaj më vonë, në një vlerë më të ulët. Në vlerësim të provave të paraqitura dhe shpjegimeve të subjektit, trupi gjykues nuk u bind mbi marrjen nga subjekti i rivlerësimit të shumës 16.800.000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë në datën 18.12.2011 nga z. E.K., pasi pavarësisht faktit se ai ndodhej në Shqipëri në momentin e kryerjes së transaksionit, nuk rezultoi asnjë dokument ligjor apo gjurmë e ndonjë transaksioni të kryer për kalimin e kësaj shume, apo për të krijuar bindjen se vetë z. E.K., e dispononte paraprakisht shumën e pretenduar.

Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti nuk ka mundur me provat e paraqitura të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit.

**72. Komisioni hetoi mbi mundësitë financiare dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. D.H., (vjehtëri i subjektit) për dhënien e huas në shumën 42.000 (dyzet e dy mijë) euro në vitin 2011, e cila është edhe burimi i dytë i të ardhurave për blerjen e apartamentit në qytetin e Tiranës.**

73. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 subjekti deklaron detyrimin financiar 42.000 (dyzet e dy mijë) euro, hua pa afat, pa interes dhe pa kontratë në datën 21.12.2011 nga vjehtëri, z. D.H., për efekt të shlyerjes së apartamentit të blerë në qytetin e Tiranës me kontratën e datës 22.11.2011.

74. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 subjekti deklaron se shuma 42.000 (dyzet e dy mijë) euro, marrë hua z. D.H., i është falur prej tij për shkak të lidhjes së ngushtë familjare dhe moshës së huadhënësit. Për këtë dhurim subjekti ka paraqitur në ILDKPKI deklaratën e datës 25.3.2014 të z. D.H., i cili deklaron faljen e huas në shumën 42.000 (dyzet e dy mijë) euro, dhënë dhëndrit dhe vajzës, duke sqaruar se e bën këtë deklaratë me shkrim mbi bazën e kërkesës së dhëndrit dhe vajzës për shkak të deklarimit të pasurisë.

75. Subjekti ka deklaruar se z. D.H., ka pasur të depozituar në bankë vlerën 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro me burim të ardhura historike nga biznesi, pagat dhe pensionet, të cilën e ka tërhequr në datën 24.11.2011, duke i dhënë subjektit hua shumën 42.000 (dyzet e dy mijë) euro. Subjekti ka paraqitur kopje të ekstraktit të llogarisë bankare të z. D.H., në “BKT”, në të cilën vërtetohet tërheqja *cash* e shumës 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro në datën 24.11.2011.

76. Gjatë hetimit të kryer nga Komisioni, lidhur me të ardhurat e z.H., Bashkia Vlorë ka përcjellë informacion në lidhje me subjektin “\*\*\*\*” me NIPT \*\*\*, ku rezulton:



- a) Për periudhën 1998 – 2006 nuk ka regjistra të asnjë tatimpaguesi pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore pranë kësaj bashkie dhe për rrjedhojë nuk mund të vërë në dispozicion dokumentacion në lidhje me detyrimet tatimore të paguara nga z. D.H.
- b) Për vitin 2007, qarkullimi është në vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë. Subjekti ka paguar taksën vendore në vlerën 10.600 (dhjetë mijë e gjashtëqind) lekë dhe taksën e biznesit të vogël në vlerën 53.000 (pesëdhjetë e tre mijë) lekë.
- c) Për vitin 2008, qarkullimi është në vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë. Subjekti ka paguar taksën vendore në vlerën 10.600 (dhjetë mijë e gjashtëqind) lekë dhe taksën e biznesit të vogël në vlerën 68.000 (gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë.
- ç) Për vitin 2009, nuk jepet informacion, subjekti rezulton i pangarkuar me detyrime për taksat dhe tarifat vendore.
- d) Për vitin 2010, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë deklaroi qarkullim në vlerën 440.000 (katërqind e dyzetë mijë) lekë.

77. Qarkullimi i dokumentuar nga Bashkia Vlorë dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë i aktivitetit të avokatisë të z. D.H., nga viti 2007 deri në vitin 2010, rezulton të jetë në vlerën 5.440.000 (pesë milionë e katërqind e dyzetë mijë) lekë.

Viti	Qarkullimi	Koment	Organi tatimor kompetent
2007	2 000 000	Qarkullimi i vlerësuar nga bashkia, paguar taksa e biznesit të vogël	Bashkia Vlorë
2008	3 000 000	Qarkullimi i vlerësuar nga bashkia, paguar taksa e biznesit të vogël	Bashkia Vlorë
2009	0	Nuk jepet informacion, nuk ka paguar taksën e biznesit të vogël	Bashkia Vlorë
2010	440 000		DRT-ja Vlorë
<b>TOTALI</b>	<b>5 440 000</b>		

78. Lidhur me shtetasin D.H., nga hetimi kanë rezultuar të dhënat për pasuri të tjera, si më poshtë:

- a) Apartament me sip. 112 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, në bashkëpronësi me shtetasen M.S.H., porositur me kontratën e sipërmarrjes datë 12.4.2010, dhe fituar me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 28.1.2016 nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në vlerën 125.000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) euro.
- b) Apartament me sip. 91,19 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, në bashkëpronësi me shtetasen M.S.H., porositur me kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 12.4.2010 dhe fituar me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 28.1.2016, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në vlerën 101.860 (njëqind e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) euro.

Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me kërkesë të Komisionit, vendos në dispozicion kontratat e shitjes së datës 28.1.2016, mandatarkëtimet, si dhe transfertat bankare sipas kontratave.

- c) Kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 17.1.2014, mes shtetasve M., dhe D.H., dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për blerjen e një apartamenti me sip. 104,26 m<sup>2</sup>, në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, me vlerë 72.982 (shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy) euro. Pagesat janë kryer me transfertë nga “BKT”. Në datën 29.12.2014 është lidhur kontrata e shitblerjes.

- ç) Apartament me sip. 47,48 m<sup>2</sup>, në rrugën nacionale “\*\*\*\*”, \*\*\*, Vlorë, fituar nga z. D.H., me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 8.6.2015, blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në vlerën 27.000 (njëzet e shtatë mijë) euro.

- d) Apartament me sip. 74,7 m<sup>2</sup>, në pallatin \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasve D., dhe M.H., përfituar me kontratën e dhurimit nr. \*\*\* rep., datë 20.6.1995, nga shtetaset B.A., (nëna e D.H.), D.A., (motra e D.H.) dhe M.A., (e bija e D.H.).

Në lidhje me këtë pasuri, ALUIZNI informon se shtetasi D.H., rezulton aplikues në procesin e legalizimit me formularin A. prot., \*\*\* Vlorë. Gjithashtu, ALUIZNI sqaron se nga verifikimi i lejeve rezulton se shtetasit D.H., M.H., dhe të tjerë, janë të pajisur me leje nr. \*\*\*, datë 20.6.2013, shtesë anësore, në godinë banimi dhe shërbimi 5-katëshe, Vlorë.

dh) Apartament me sip. 70 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi të shtetasve D., dhe M.H. Nga hetimi ka rezultuar se shtetasit D.H., M.H., dhe shtetas të tjerë kanë në proces legalizimi një sipërfaqe ndërtimi prej 70 m<sup>2</sup> në z.k. \*\*\*, Vlorë.

78.1 Nga informacioni i administruar nga bankat, rezulton se shtetasit D., dhe M.H., kanë pasur llogari dhe depozita në banka të ndryshme në periudhën 1997 – 2012, me vlera të konsiderueshme [nga 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë deri në 130.000 (njëqind e tridhjetë mijë) euro].

79. Në përfundim, Komisioni ka përlllogaritur aftësinë e kursimit të bashkëshortëve H., për periudhën 2004 – 2010, duke përfshirë të ardhurat nga pagat dhe pensionet, fitimin në masën 80% mbi vlerën minimale të qarkullimit vjetor (0 - 2.000.000 lekë/vit) nga aktivitei i avokatisë për periudhën 2004 – 2006, si dhe mbi fitimin që rezulton nga dokumentacioni për periudhën 2007 – 2010. Nga kjo përlllogaritje duket se aftësia e tyre e kursimit për periudhën 2004 – 2010 ka qenë në vlerën 12.065.293 (dymbëdhjetë milionë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.

80. Nga hetimi ka rezultuar se deri në datën e dhënies së kësaj huaje (më 21.12.2011), bashkëshortët H., kanë blerë pasuri të paluajtshme në vlerën 29.068.500 (njëzet e nëntë milionë e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë, si dhe kanë disponuar likuiditete bankare deri në fund të vitit 2010, në vlerën 27.139.742 (njëzet e shtatë milionë e njëqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e dy) lekë. Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është një nga trashëgimtarët e ligjshëm (sipas pjesës takuese) të z. D.H.

**81. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar me dokumentacion justifikues ligjor përfitimin e huas (dhuruar në vijim), si dhe mundësitë financiare të z. D.H., për të krijuar me burime të ligjshme sipas parashikimit të paragrafit 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, shumën 42.000 (dyzet e dy mijë) euro [ose 5.808.600 (pesë milionë e tetëqind e tetë mijë e gjashtëqind) lekë], të dhënë hua në vitin 2011, si dhe njëkohësisht të krijonte pasuri të paluajtshme dhe të dispononte likuiditete në bankë.**

82. Në vijim të rezultateve të hetimit dhe barrës së provës, subjekti shpjegon si vijon:

*“Ju kemi vënë në dispozicion statement bankar të Bankës Kombëtare Tregëtare, nga ku rezulton se i ndjери ka pasur në bankë të depozituar vlerën prej 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro (të ardhura historike nga biznesi, pagat dhe pensionet) dhe e ka tërhequr në datën 24.11.2011.*

*Analiza juaj mbi mundësinë e kursimit të çiftit H., është pjesore dhe jo e plotë, ndërkohë që unë ju provoj që vetëm në sistemin bankar familja H., ka pasur të kursyer deri në vitin 2004 vlerën në total prej 11.850.524 ( njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind e njëzetë e katër) lekë.*

*Përveç të ardhurave të mësipërme ju nuk keni përfshirë as fitimin e tij deri në vitin 2006 që provohet të paktën me 122 vendime gjyqësore, gjithashtu, nuk keni përfshirë as të ardhurat nga pagat dhe pensionet.*

*Pasuritë e paluajtshme të familjes H., dhe likuiditetet bankare janë siguruar nga puna e të dy bashkëshortëve, veçanërisht nga avokatia dhe ato nuk janë fituar në vitin 2010 dhe 2011 sikundër del në barrën e provës që më keni ngarkuar. Krijimi i pasurive të paluajtshme janë rrjedhojë e punës së gjithë jetës së çiftit H.”*

83. Nga rivlerësimi i shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit ligjor provues të disponueshëm nga Komisioni, aftësia e kursimit të z. D.H., dhe bashkëshortes deri në vitin 2011, rezulton sipas tabelës:

Përshkrimi	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	Total deri në fund të vitit 2010
Të ardhura neto nga paga M.H.	171,474	223,010	256,276	259,668	297,354	311,663	319,860	1,839,306
Të ardhura nga pensioni i pleqërisë + suplementar D.H.	151,398	161,633	170,238	178,236	219,907	268,248	340,285	1,489,945
<b>Total të ardhura nga puna dhe pensionet *** H.</b>	<b>322,872</b>	<b>384,643</b>	<b>426,514</b>	<b>437,904</b>	<b>517,261</b>	<b>579,911</b>	<b>660,145</b>	<b>3,329,251</b>
Të ardhura nga avokatia D.H.	0	0	0	1,600,000	2,400,000	0	155,158	4,155,158
Kthim borxhi nga Andi Civici për blerjen e apartamentit ne vitin 2003				100,000	800,000	600,000	0	1,500,000
<b>TOTAL të ardhura D., &amp; M.H.</b>	<b>322,872</b>	<b>384,643</b>	<b>426,514</b>	<b>2,137,904</b>	<b>3,717,261</b>	<b>1,179,911</b>	<b>815,303</b>	<b>8,984,409</b>
Shpenzime jetike per dy persona	187,928	219,114	219,114	273,240	273,240	273,240	273,240	1,719,116
<b>AFTËSIA PËR TË KURSYER 2004 - 2011</b>	<b>134,944</b>	<b>165,529</b>	<b>207,400</b>	<b>1,864,664</b>	<b>3,444,021</b>	<b>906,671</b>	<b>542,063</b>	<b>7,265,293</b>

83.1 Nga përlllogaritjet rezulton se aftësia e kursimit për periudhën 2004 – 2010 (duke zbritur shpenzimet jetike për 2 persona) ka qenë në vlerën 7.265.293 (shtatë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.

Trupi gjykues vendosi të mos i konsiderojë të ardhurat nga avokatia të pretenduara nga subjekti për periudhën 1998 –2006, pasi nuk disponoi asnjë dokumentacion ligjor provues për regjistrimin në organet tatimore deri në vitin 2003 dhe pagesën e tatimeve përkatëse, po ashtu xhiron apo qarkullimin vjetor deri në vitin 2006.

Megjithëse nga informacioni i ardhur nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, rezulton se shtetasi D.H., figuron i regjistruar si person fizik në datën 27.3.2003 me NIPT \*\*\* dhe veprimtari “aktivitete juridike” dhe se është çregjistruar nga regjistrat e administratës tatimore në datën 27.5.2015, Komisioni nuk disponoi ndonjë dokumentacion mbi qarkullimin nga ky aktivitet deri pas vitit 2006.

Në tabelë janë përfshirë të ardhurat e dokumentuara nga avokatia për periudhën 2007 – 2010. Mbi qarkullimin e dokumentuar është aplikuar marzhi i fitimit 80 %. Nuk janë përfshirë gjithashtu as të ardhurat e vitit 2011.

83.2 Gjithashtu, te të ardhurat e kësaj periudhe është përfshirë edhe vlera 1.500.000 lekë, të cilën subjekti e deklaroi (në deklaratën periodike vjetore) se ia ka kthyer z. D.H., për shlyerjen e huas në vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë, të marrë në vitin 2003. Nga analiza financiare e subjektit, rezultoi se ai ka pasur mundësi ta shlyejë me burime të ligjshme, këtë shumë (në vitet 2007, 2008 dhe 2009).

Subjekti ka pretenduar të përfshihet te të ardhurat e vjehrrit edhe vlera 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë në vitin 2011, por nga deklaratimet në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, subjekti ka deklaruar se kjo shumë i është paguar z. D.H., në datën 18.12.2011 nga të ardhurat nga shitja e apartamentit në Vlorë dhe nga ana tjetër, subjekti ka deklaruar se burimi i shumës 42.000 (dyzetë e dy mijë) euro është tërheqja e shumës 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro nga BKT-ja, kryer nga z. H., në datën 24.11.2011, të cilën ia ka dhënë subjektit në datën 21.12.2011. Rrjedhimisht, nuk është pranuar pretendimi i subjektit për të përfshirë te burimi i kësaj shume edhe vlerën prej 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë të cilën ia ka dhënë vjehrrit në dhjetor 2011, nga të ardhurat nga shitja e apartamentit në Vlorë.

84. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete dhe rrethanave specifike të tyre, përveçse kur ka dyshime për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur.

Në analizë të të ardhurave të ligjshme të huadhënësit dhe të dokumentuara dhe shpenzimeve jetike të kryera, arrihet në konkluzionin se personi tjetër i lidhur justifikon me burime të ligjshme krijim e shumës 42.000 (dyzet e dy mijë) euro të dhënë hua dhe të dhuruar më pas subjektit të

rivlerësimit dhe bashkëshortes, konkluzion i cili kënaq kërkesat e nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016.

Duke vlerësuar aktivitetin privat të huadhënësit të rezultuar edhe gjatë hetimit, situatën financiare të tij të rezultuar nga gjendjet e likuiditeteve dhe kursimeve në bankë, duke njohur realitetin shqiptar të atyre viteve ku informaliteti ka qenë i dukshëm dhe real për këdo, lidhur me pasuritë e tjera të z. D.H., dhe bashkëshortes, blerë me të ardhura që disponoheshin nëpërmjet sistemit bankar, trupi gjykues vlerëson se, ato mund të jenë nga aktiviteti i avokatisë i të ndjerit D.H., dhe veprimtaria tregtare e ushtruara prej tij ndër vite (1998-2015), dhe se ato nuk mund të vlerësohen në kuadër të procesit të rivlerësimit të z. Andi Civici.

Ky konkluzion i trupit gjykues vjen në harmonizim me parashikimet kushtetuese, ato ligjore, si dhe orientimet jurisprudenciale, të konfirmuar dhe të konsoliduar nga disa vendime të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (si p.sh: vendimet: nr. 9, datë 18.4.2019, nr. 14, datë 9.7.2019; nr. 15, datë 17.07.2019; nr. 20 datë 31.7.2019).

85. Në përfundim, lidhur me pasurinë apartament me sip. 147,80 m<sup>2</sup>, në Rr. “\*\*\*”, Tiranë, në vlerën 155.000 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) euro, trupi gjykues krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramë të pasakta në përputhje me ligjin dhe nuk ka mundur të provojë plotësisht burimin e ligjshëm për krijimin e saj.

Mosdokumentimi ndër vite, me transparencë, i veprimeve të kryera për: marrjen e huave në vitin 2003 apo likuidimi i tyre; marrja e vlerës nga shitja e apartamentit në qytetin e Vlorës; apo marrja e huas në vitin 2011; nisur edhe nga fakti se të dy bashkëshortët ishin gjyqtarë dhe deklarorin rregullisht pasuritë dhe të ardhurat e tyre, i krijuan bindjen trupit gjykues se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramë të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri të tij dhe se nuk arriti të provojë bindshëm lidhur me burimin e ligjshëm të disa prej të ardhurave të përfituara për krijim e kësaj pasurie dhe mënyrën e përfitimit të tyre.

86. **Garazh me me sip. 30,36 m<sup>2</sup>**, me nr. pasurie \*\*\*, në vlerën 920.000 (nëntëqind e njëzet mijë) lekë, i ndodhur në pallatin e apartamentit të banimit në Tiranë, blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 17.4.2015.

87. Burimi për blerjen e garazhit janë kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes nga të ardhurat për vitet 2013, 2014 deri më 17.4.2015, depozituar në “Raiffeisen Bank” në datën 21.3.2014 dhe interesat përkatëse të kësaj depozite me nr. \*\*\*, e cila më pas ka kaluar në llogarinë e pagës nr. \*\*\*.

88. Nga informacioni i administruar rezulton se subjekti ka transferuar nga llogaria e tij rrjedhëse vlerën 920.000 (nëntëqind e njëzet mijë) lekë në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në datën 17.4.2015, me përshkrimin “pagesë për garazh”, me burim nga mbyllja e depozitës nr. \*\*\* në “Raiffeisen Bank”.

89. Në lidhje me krijimin e depozitës nr. \*\*\* në “Raiffeisen Bank” në vitin 2014, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2015, rezulton se subjekti ka çelur depozitën nr. \*\*\* në “Raiffeisen Bank”, në datën 21.3.2014, duke depozituar *cash* vlerën 620.000 (gjashtëqind e njëzet mijë) lekë. Më pas kjo depozitë është shtuar me të ardhurat nga paga e subjektit, në mënyrë të përmuajshme, deri në datën 23.3.2015.

90. Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar burimin e krijimit të shumës 620.000 (gjashtëqind e njëzet mijë) lekë e cila krijohet nga deklarimi i gjendjes *cash* në vlerën 520.000 (pesëqind e njëzetmijë) lekë në vitin 2013 dhe vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë në vitin 2014.

Nga analiza, rezultoi se subjekti nuk justifikon plotësisht kursimet *cash* në vitin 2013 dhe se justifikon me burime të ligjshme vetëm vlerën prej 100.000 (njëqind mijë) lekësh të kursyer deri në datën 21.3.2014.

**91. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën.**

92. Subjekti ka paraqitur disa kundërshtime në lidhje me analizën financiare të kryer nga Komisioni (të trajtuar gjerësisht në vijim), përfshirë edhe rezultatin financiar të vitit 2013 dhe shpjegon se në bazë të përlllogaritjeve të tij, analiza del me një rezultat pozitiv në vitin 2013, rrjedhimisht edhe depozita e cila ka shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie.

93. Nga përlllogaritjet e kryera pas prapësimeve të subjektit (ndryshim shpenzime *TIMS* dhe shpenzime shkollimi), duket se aftësia reale e kursimit të subjektit në vitin 2013 ka qenë në vlerën 411.270 (katërqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë, e cila së bashku me shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë të kursyera deri në datën 21.3.2014, kanë shërbyer për krijimin e depozitës 620.000 (gjashtëqind e njëzet mijë) lekë në “Raiffeisen Bank”.

Kjo depozitë, që nga data 21.3.2014 është shtuar me shuma periodike të transferuara nga llogaria e pagës së subjektit dhe në datën 23.3.2015 subjekti ka transferuar te llogaria rrjedhëse shumën e nevojshme për blerjen e garazhit.

Bazuar në këtë rezultat, subjekti e justifikon me burime të ligjshme blerjen e garazhit në vitin 2015, në vlerën 920.000 (nëntëqind e njëzet mijë) lekë, duke rezultuar me një diferencë minimale negative -24.010 (njëzet e katër mijë e dhjetë) lekë.

94. **Automjet tip “Audi”**, i përdorur, vit i prodhimit 2009, blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 12.5.2015, në vlerën 13.500 (trembëdhjetë mijë e pesëqind) euro.

95. PAGESA është kryer nga depozita nr. \*\*\*. Kjo depozitë është krijuar nga shitja e automjetit tip “Daimler Chrysler” me kontratën nr. \*\*\*, datë 23.3.2015, në vlerën 15.800 (pesëmbëdhjetë mijë e tetëqind) euro. Ky automjet ishte blerë në datën 18.5.2010 nga depozita e krijuar prej çmimit të shitjes së automjetit tip “Benz”, sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 11.5.2007, interesave përkatëse të depozitës dhe nga kursimet e të ardhurave nga puna e subjektit dhe e bashkëshortes. Automjeti i shitur me kontratën datë 11.5.2007 ishte blerë në datën 13.11.2003, me kontratën nr. \*\*\*, me të ardhurat e përfituara nga subjekti dhe bashkëshortja pjesërisht nga paga e punës dhe të ardhura para fillimit të detyrës.

96. Nga hetimi ka rezultuar se automjeti është blerë nga z. S.B., në datën 28.4.2015 jashtë vendit me \*\*\*, në vlerën 9.200 (nëntë mijë e dyqind) euro, si dhe janë paguar shpenzime zhdoganimi në vlerën 262.434 (dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e tridhjetë e katër) lekë.

97. Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 blerjen e automjetit tip “Audi” me kontratën nr. \*\*\*, datë 12.5.2015, në vlerën 13.500 (trembëdhjetë mijë e pesëqind) euro, e cila është paguar në datën 13.5.2015 nga llogaria rrjedhëse nr. \*\*\*, në emër të subjektit në “Tirana Bank”, e cila konfirmon pagesën e vlerës 13.500 (trembëdhjetë mijë e pesëqind) euro në favor të z. S.B., për blerje automjeti.

98. Në lidhje me automjetin tip “Daimler Chrysler”, me targa \*\*\*, i cili ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Audi” në vitin 2015, subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” shitjen e automjetit tip “Daimler Chrysler” në vlerën 15.800 (pesëmbëdhjetë mijë e tetëqind) euro, si dhe ka paraqitur kopje të kontratës noteriale me të cilën është kryer ky transaksion.

Banka konfirmon pagesën e vlerës 15.800 (pesëmbëdhjetë mijë e tetëqind) euro në këtë llogari bankare në emër të subjektit nga shtetasi K.S.N., për blerje automjeti.

99. Për blerjen e këtij automjeti, subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 blerje të automjetit tip “Mercedes Daimler Chrysler”, me targa \*\*\*, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në Gjermani në datën 22.5.2010, në vlerën 13.300 (trembëdhjetë mijë e treqind) euro, si dhe shpenzime doganore në vlerën 651.400 (gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë, të cilat i ka paguar në datën 22.5.2010.

DPSHTRr-ja konfirmon blerjen e këtij automjeti nga subjekti prej shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në Gjermani në datën 22.5.2010, me deklaratën doganore nr. \*\*\*, në vlerën 13.300 (trembëdhjetë mijë e treqind) euro [ose 1.846.173 (një milion e tetëqind e dyzet e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë] dhe pagesën e vlerës 650.952 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy) lekë taksa doganore. Në total, vlera e automjetit të blerë nga subjekti, përlllogaritur sipas kursit mesatar të Bankës së Shqipërisë, rezulton të jetë 2.497.573 (dy milionë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

100. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 subjekti deklaroi si burim për blerjen e automjetit huan pa kontratë dhe pa interes të marrë në datën 1.5.2010 nga z. D.H., (vjehtëri i tij), në shumat 13.300 (trembëdhjetë mijë e treqind) euro [ose 1.830.479 (një milion e tetëqind e tridhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë] dhe 651.400 (gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë.

101. Në lidhje me huadhënien e vlerës 13.300 (trembëdhjetë mijë e treqind) euro në vitin 2010, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Daimler Chrysler”, subjekti ka shpjeguar se ia ka marrë shumën hua vjehtërit, pasi kursimet e tij ishin të mbyllura në llogarinë bankare, e cila përfundonte afatin e maturimit në datën 20.7.2010, dhe për të mos humbur përqindjen e interesit ka marrë hua tek vjehtëri shumën e nevojshme, dhe më pas ka shlyer vlerën 1.130.062 (një milion e njëqind e tridhjetë mijë e gjashtëdhjetë e dy) lekë, me burim mbylljen e depozitës në “Raiffeisen Bank” dhe vlera 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, me burim kursimet nga të ardhurat vjetore, shlyer në datën 28.12.2010. Subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion provues për ekzistencën e kësaj marrëdhënieje.

102. Nga verifikimet e kryera nga Komisioni konfirmohen veprimet e deklaruara nga subjektit lidhur me llogarinë bankare dhe janë në përputhje me dokumentacioni bankar të administruar. “Raiffeisen Bank” ka konfirmuar se subjekti ka çelur depozitën bankare nr. \*\*\* në datën 12.9.2007, duke kryer derdhjen e vlerës *cash* prej 900.000 (nëntëqind mijë) lekë.

Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se kjo depozitë është krijuar nga shitja e automjetit tip “Benz” sipas kontratës noteriale nr. \*\*\*, datë 11.5.2007.

103. Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, të ardhura nga shitja e automjetit sipas kontratës noteriale nr. \*\*\*, datë 11.5.2007, në vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë dhe depozitë në “Raiffeisen Bank”, e çelur më 12.9.2007, në vlerën 906.500 (nëntëqind e gjashtë mijë e pesëqind) lekë.

104. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti e justifikon me burime të ligjshme krijimin e depozitës të çelur në “Raiffeisen Bank” në vitin 2007 (me burim shitjen e automjetit “Benz” të blerë në vitin 2003).

Subjekti e justifikon me burime të ligjshme shumën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, të përdorur për shlyerjen pjesore të huas së marrë nga z. D.H., (më 28.12.2010), me qëllim blerjen e automjetit tip “Daimler Chrysler”, me targa \*\*\*.

105. Bashkëlidhur deklaratës “Vetting” subjekti depoziton kontratën e shitblerjes së automjetit, sipas së cilës subjekti në datën 13.11.2003 blen nga shtetasi A.M., automjetin tip “Benz 200D”, në vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, e cila është paguar plotësisht para redaktimit të kontratës jashtë zyrës noteriale.

Nga analiza financiare për periudhën 1999 – 2003, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen kësaj pasurie, kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e likuiditeteve, duke e justifikuar blerjen e këtij automjeti me burime të ligjshme.

106. Lidhur me këtë pasuri, në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të mjaftueshme dhe nga burime të ligjshme për krijimin e tyre.

107. Nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk u gjet ndonjë e dhënë për të drejta pronësie apo përdorimi të automjeteve të tjera, përveçse automjeteve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

108. **Gjendja cash në banesë në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë.** Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 kursime cash në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë, me burim kursimet nga pagat e përfituara prej tij dhe bashkëshortes në vitin 2016. Mundësitë financiare për krijimin e kësaj gjendjeje cash trajtohen në analizën financiare të kryer nga Komisioni, për subjektin e rivlerësimit.

109. Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se kursimet nga të ardhurat e krijuara para fillimit të detyrës (me burim nga puna si përkthyes në \*\*\* dhe \*\*\* Albania, si dhe përkthime të tjera) janë depozituar më 20.8.2003, në vlerën 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë në “Tirana Bank” në llogarinë nr. \*\*\* dhe janë tërhequr në datën 4.6.2004 në vlerën 1.679.683 (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë. Subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës “Vetting” kopje të ekstraktit bankar të sipërpërmendur, për vitet 2003 – 2004, në emër të subjektit dhe babait të tij, e cila konfirmon deklaratimet e subjektit. “Tirana Bank” konfirmon se subjekti dhe babai i tij kanë pasur një llogari bashkëmërore, të çelur në datën 20.8.2003 ku z. Ll.C., ka derdhur shumën cash 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë, e cila ka kaluar në depozitë deri në datën 4.6.2004, në të cilën kjo llogari është mbyllur përfundimisht.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, subjekti nuk deklaroi depozitë/llogari bankare në “Tirana Bank”, por vetëm gjendje cash në vlerën 770.000 (shtatëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, si dhe një llogari bankare bashkëmërore me babanë të “Banka Kombëtare Greke” (me burim kursimet e babait).

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 subjekti deklaroi depozitë kursimesh të “Tirana Bank” (e mbyllur brenda vitit 2004) në vlerën 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë, me burim 770.000 (shtatëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë nga viti 2003 dhe 930.000 (nëntëqind e tridhjetë mijë) lekë nga pagat e vitit 2004.

Subjekti deklaroi se: *“... shuma 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë, depozituar më 20.8.2003 është pasqyruar prej meje për herë të parë në deklaratimin fillestar të vitit 2003. Në atë deklaratim, si burim të shumës unë kam përmendur, përveç të ardhurave të krijuara nga \*\*\* dhe \*\*\*, deri në vitin 2000, edhe kursime nga paga si gjyqtar (shihni deklaratën fillestare, viti 2003 formulari A-5). Pra, ajo që kam dashur të përshkruaj në deklaratën “Vetting” është se një pjesë e të ardhurave të kësaj shume datojnë deri në vitin 2000, ndërkohë që një pjesë janë nga kursimet e pagës si gjyqtar të mijat dhe të bashkëshortes.”*

Nga analiza financiare e periudhës 1999 – 2003, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e depozitës në vitin 2003.

110. Subjekti ka deklaruar në pyetësorin standart se babai i bashkëshortes së tij, z. D.H., ka paguar vlerën 4.300 (katër mijë e treqind) euro për mbulimin e shpenzimeve të arsimimit të fëmijëve të tij në kolegjin “\*\*\*\*” në vitin 2014. Subjekti sqaron në përgjigje të rezultateve të hetimit se këto veprime janë kryer nga z. D.H., nëpërmjet bankës, duke paraqitur si provë kopje të noterizuar të mandatpagesave të kryera prej tij tek “Intesa Sanpaolo Bank” gjatë vitit 2014, në vlerë totale prej 4.300 (katër mijë e treqind) euro. Kjo shumë, nuk është përfshirë fillimisht në analizën financiare të Komisionit, të seksioni i të ardhurave të vitit 2014, pasi subjekti nuk e ka deklaruar si dhurim në deklaratën periodike vjetore. Subjekti e deklaroi këtë fakt në pyetësorin standard të dërguar gjatë procesit të rivlerësimit dhe paraqiti provat dhe shpjegimet e tij gjatë rezultateve të hetimit të dërguara nga Komisioni.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se z. D.H., ka pasur mundësi financiare, si dhe likuiditete në bankë të mjaftueshme për kryerjen e kësaj pagese gjatë vitit 2014.

Këto prova dhe shpjegime të subjektit janë reflektuar në analizën financiare të rishikuar të Komisionit.

111. Nga sistemi *TIMS* rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë përdorur disa mjete në pronësi të personave të ndryshëm.

Nga sistemi u nxorën të dhënat *TIMS* për këta persona dhe u pyet subjekti mbi lidhjen me shtetasit e mësipërm, i cili deklaroi se personat janë të afërm ose të njohur të tij ndërsa disa prej auomjeteve mund të jenë të institucioneve me të cilat ka lëvizuar ai ose bashkëshortja për udhëtim pune.

Metodologjia e përlogaritjes së shpenzimeve nga Komisioni, për udhëtimet jashtë vendit të kryera nga subjekti, bashkëshortja dhe fëmijët e tij për periudhën e rivlerësimit, nuk përfshin shpenzime për udhëtimet e kryera për shkak të funksionit<sup>2</sup>, janë përlogaritur shpenzime të reduktuara për udhëtimet në të cilat subjekti ka deklaruar se ka qëndruar te të afërmit<sup>3</sup> dhe e ka provuar atë, si dhe janë përlogaritur shpenzime të plota për udhëtimet për të cilat subjekti ka deklaruar se ka qëndruar te të afërmit, por për të cilat nuk ka paraqitur dokumentacion.

112. Nga analiza financiare për periudhën 2003 - 2016, e rishikuar pas paraqitjes së provave dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk i justifikojnë plotësisht pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera gjatë kësaj periudhe me të ardhura nga burime të ligjshme, duke rezultuar me një diferencë negative në shumën - 879.551 (tetëqind e shtatë dhjetë e nëntë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një) lekë.

---

<sup>2</sup>Për të cilat subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues.

<sup>3</sup>Për të cilat subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues.





113. Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017 blerje të automjetit tip “Golf Volkswagen”, viti i prodhimit 2006, me targa \*\*\*, në emër të bashkëshortes, sipas kontratës së përpiluar në Gjermani, me autorizimin e bashkëshortes, në vlerën 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro + 76.231 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e një) lekë shpenzime zhdoganimi.

114. Burimi i krijimit janë kursimet *cash* të vitit 2016 dhe të ardhura nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes gjatë vitit 2017.

115. Nga informacioni i administruar nga DPSHTRr-ja rezulton se ky automjet është blerë nga znj. E.C., në datën 2.5.2017, tek shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në Gjermani, sipas deklaratës doganore nr. \*\*\*, në vlerën 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro [ose 337.525 (treqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë] + taksa doganore 79.226 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e një) lekë. Në total, çmimi i blerjes së këtij automjeti rezulton të jetë në vlerën 416.751 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një) lekë.

116. Në lidhje me burimet për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1 janar – 25 prill 2017, e cila paraqitet në tabelën e mëposhtme:

PËRSHKRIMI	VLERA
Kursime <i>cash</i> 2016 të justifikuar me burime të ligjshme	261 280
Tërheqje nga llogaria e pagës në “Raiffeisen Bank”, Andi Civici, 1 janar - 25 prill 2017	409 000
Tërheqje nga llogaria e pagës në “Raiffeisen Bank”, E.C., 1 janar - 25 prill 2017	373 000
<b>TOTAL TË ARDHURA</b>	<b>1 043 280</b>
Blerje automjeti “Golf Volkswagen”, me targa ***	416 751
Shpenzime jetike 1 janar - 25 prill 2017	313 456
Udhëtime jashtë vendit sipas sistemit <i>TIMS</i> 1 janar - 25 prill 2017	95 062
<b>TOTAL SHPENZIME</b>	<b>825 269</b>
<b>Aftësia për të kursyer 1 janar - 25 prill 2017</b>	<b>218 011</b>

Kjo analizë përfshin gjendjen *cash* në vlerën 261.280 (dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë, të vitit 2016, e cila rezultoi e justifikuar nga subjekti me burime të ligjshme.

Në përfundim rezulton se subjekti e justifikon me burime të ligjshme blerjen e automjetit tip “Golf Volkswagen” në vitin 2017.

117. Subjekti ka deklaruar se djali i tij, K.C., në vitin 2019 ka aplikuar për bursë në kolegjin \*\*\* (\*\*\*) në Costa Rica dhe ka përfituar bursë në masën 50 % të vlerës së tarifës së studimeve për vitin 2019. Pjesa tjetër e tarifës në vlerën 19.050 (nëntëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë) USD<sup>4</sup>, është paguar nga subjekti i rivlerësimit, dhe përfshin shpenzimet e studimit, të akomodimit në kampus, ushqimin, librat shpenzimet për kujdesin mjekësor.

118. Subjekti, për të përballuar këtë shpenzim, ka marrë një kredi në “Raiffeisen Bank” në vlerën 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë në datën 17.5.2019, e cila është siguruar me të gjitha pasuritë e subjektit dhe do të përballohet nga paga e tij. Kjo shumë, së bashku me kursimet vjetore të vitit 2019 të derdhura në bankë, ka shërbyer për transfertën e vlerës 20.195 (njëzet mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) USD<sup>5</sup>, kundrejt \*\*\*, ku përfshihet edhe një depozitë dëmsh prej 500 (pesëqind) USD.

119. Subjekti ka deklaruar gjithashtu se në datën 8.8.2019 ka udhëtuar me bashkëshorten dhe djalin në Costa Rica, ku kanë qëndruar 2 javë për të shoqëruar të birin. Për këtë udhëtim

<sup>4</sup> Ose 2.092.833 (dy milionë e nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë.

<sup>5</sup> Ose 2.218.622 (dy milionë e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e dy) lekë

subjekti deklaron shpenzime udhëtimi në vlerën 3.050 (tre mijë e pesëdhjetë) euro dhe shpenzime qëndrimi në vlerën 1.153 (një mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) USD.

120. Subjekti, i pyetur nga Komisioni nëse ka parashikuar se si do të vazhdojë të paguajë studimet e të birit në vitet në vijim, ka deklaruar se djalit i mbetet edhe një vit tjetër studimi në Costa Rica dhe për të paguar shpenzimet e vitit shkollor 2020 – 2021 do të aplikojë sërish për kredi.

Subjekti deklaron se i biri nuk disponon llogari bankare, pasi është minorene dhe se nuk transferon asnjë shumë nëpërmjet bankës, tek i biri (për këtë semestër prindërit i kanë dhënë shumën 300 USD për çdo nevojë *extra* që mund të ketë).

Në datën 17.10.2019 subjekti dërgon në Komision shpjegime shtesë lidhur me shkollimin e të birit duke sqaruar, ndër të tjera, procedurat e konkurrimit të cilave u është nënshtruar i biri K.C. Gjithashtu, subjekti shprehet se të birit i lindte e drejta për të kërkuar bursën e ofruar në \*\*\*, Kinë dhe atë në Costa Rica. \*\*\*, Kinë, ishte një kolegji i ri me kushte absolutisht shumë të mira të konviktit, ndërkohë që \*\*\* Costa Rica ka qenë fshat SOS dhe kushtet janë tërësisht modeste. Subjekti shpjegon se i biri zgjodhi si mundësi të parë \*\*\* Costa Rica, pasi shpenzimet ishin më të ulëta dhe vendos në dispozicion të Komisionit një video të xhiruar në ditën e parë të paraqitjes së djalit për të parë nivelin e thjeshtë të jetesës në kampus.

121. Subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues si vijon:

- Kontratën financiare me \*\*\* Costa Rica, ku përcaktohet qartë se shpenzimet e studimit në këtë kolegji për vitet shkollorë 2019 – 2021 janë në vlerën 76.200 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind) USD, ose 38.100 (tridhjetë e tetë mijë e njëqind) USD në vit dhe se studenti K.C., ka përfituar bursë në masën 50 % për çdo vit dhe kostoja që duhet të përballohet nga prindërit është në vlerën 38.100 (tridhjetë e tetë mijë e njëqind) USD ose 19.050 (nëntëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë) USD në vit.
- Kopje të faturës për vitin 2019 – 2020, ku përcaktohet tarifa në vlerën 19.050 (nëntëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë) USD.
- Kontratën e kredisë së përfituar nga “Raiffeisen Bank”, në vlerën 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë në vitin 2019.
- Dokumentacion në lidhje me shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit në Costa Rica në shtator të vitit 2019, me qëllim shoqërimin e të birit.
- Video të konviktit ku aktualisht jeton i biri.

122. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti justifikon me të ardhura nga burime të ligjshme shpenzimet e kryera në vitet 2017, 2018 dhe 2019 dhe se ato janë në përputhje me dokumentacion e administruar nga Komisioni.

123. Trupi gjykues i Komisionit, në përfundim të hetimit administrativ për kriterin e pasurisë, arriti në konkluzionin se provat për kriterin e pasurisë kanë nivelin e provueshmërisë, pasi subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave për krijimin e tyre, sipas përcaktimit në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84.2016 dhe nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit, lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë apartament banimi në qytetin e Vlorës në vitin 2003, për të cilën në deklaratën “Veting” ka deklaruar se ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit me sip.147,80 m<sup>2</sup>, në vlerën 155.000 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) euro, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, fituar me kontratën e shitjes me rezervë nr. \*\*\*, datë 22.12.2011, dhe kontratën përfundimtare të shitjes nr. \*\*\*, datë 1.10.2012.

Subjekti nuk ka mundur të bindë Komisionin lidhur me vërtetësinë e transaksionit financiar të kryer me z. E.K., për shitjen e apartamentit në qytetin e Vlorës në vitin 2011, për të cilën në

deklaratën “Veting” ka deklaruar se ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit me sip. 147,80 m<sup>2</sup>, në vlerën 155.000 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) euro, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, fituar me kontratën e shitjes me rezervë nr. \*\*\*, datë 22.12.2011 dhe kontratën përfundimtare të shitjes nr. \*\*\*, datë 1.10.2012.

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një balancë negative në shumën - 879.551 (tetëqind e shtatë dhjetë e nëntë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një) lekë, pa përfshirë rezultatin e hetimit lidhur me apartamentin në Tiranë dhe burimin për krijimin e asaj pasurie ndër vite.

124. Përfundimet e mësipërme u vlerësuan të mjaftueshme nga trupi gjykues për të konkluduar lidhur me rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, mbështetur vetëm në kriterin e pasurisë, pasi çdo përfundim tjetër lidhur me vlerësimin e kriterëve të tjerë nuk do të mund ta çonte në një vlerësimi të ndryshëm për zgjidhjen e çështjes.

125. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, bazuar në përfundimet e arritura, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës, dhe në nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Andi Civici, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë në datën 4.3.2020.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Kryesues**  
**Roland ILIA**

**Relatore**  
**Valbona SANXHAKTARI**

**Anëtare**  
**Xhensila PINE**

*Sekretare gjyqësore*  
*Fiorela Mandro*